



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.2

15 janar

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.6008 datë 14.1.2009	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin	9
Vendim i KM nr.4, datë 7.1.2009	Për një shtesë në vendimin nr.584, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar	9
Vendim i KM nr.5, datë 7.1.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.96, datë 3.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e aktiveve, në mbulim të provigjoneve, teknike dhe matematike, dhe të kufijve maksimalë të investimeve të tyre nga shoqëritë e sigurimeve”	10
Vendim i KM nr.9, datë 7.1.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kolonjë, të qarkut të Fierit	10
Vendim i KM nr.10, datë 7.1.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Horë-Vranisht, të qarkut të Vlorës	11
Vendim i KM nr.11, datë 7.1.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	12
Vendim i KM nr.12, datë 7.1.2009	Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës mecilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar	13
Udhëzim i MF dhe DPRSH nr.1, datë 8.1.2009	Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive	15

DEKRET
Nr.6008, datë 14.1.2009

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN

Në mbështetje të neneve 92, shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës dhe të nenit 184 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin zhvillohen ditën e diel, më datë 28 qershor 2009.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.4, datë 7.1.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.584, DATË 28.8.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, 22, pika 2, 23, pika 2, 24, pika 4, e 25, pika 4 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Integritimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 21, të vendimit nr.584, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“21/1 Në tekstin e projektaktit me karakter normativ, që kërkon përafrimin me *asquis communautaire*, shënohen numri CELEX, data e miratimit dhe titulli i plotë i instrumentit ligjor të *asquis communautaire*, me të cilin është përafruar projektakti. Referenca e instrumentit ligjor të *asquis communautaire* bëhet, nëpërmjet një shënimi në fund të faqes së parë të lidhur me titullin e projektaktit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.5, datë 7.1.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.96, DATË 3.8.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E AKTIVEVE, NË MBULIM TË PROVIGJONEVE, TEKNIKE DHE
MATEMATIKE, DHE TË KUFIJVE MAKSIMALË TË INVESTIMEVE TË TYRE NGA
SHOQËRITË E SIGURIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 105 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.96, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “b”, të pikës 4, shprehja “...20% të provigjoneve, teknike dhe matematike...” zëvendësohet me “...30% të provigjoneve, teknike dhe matematike...”.

2. Pika 5 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**VENDIM
Nr.9, datë 7.1.2009**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS
KOLONJË, TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kolonjë, të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Kolonjë, të qarkut të Fierit, miratuar në vendimin nr.164, datë 25.3.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kolonjë, të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kolonjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kolonjë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
--	------------------------------	----------------------

1-9	Prona që përdoret për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
98-106	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
112-117	Varreza publike	Në pronësi
171-179,184-192,194,195	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
118-168	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
202-209	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
302	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
14-26	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
40-97	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
180-183	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit. (toka produktive)	Në përdorim
27-39, 219, 244, 251, 261, 276, 279, 287, 291	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit. (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi

VENDIM
Nr.10, datë 7.1.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS HORË-VRANISHT, TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Horë-Vranisht, të qarkut të Vlorës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 106 (njëqind e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 718 (shtatëqind e tetëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Horë-Vranisht për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-14	Prona që përdoret për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
15-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
21-38	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive kulturore dhe historike	Në pronësi
42-53	Infrastrukturë (shërbim funeral) dhe shërbim publik	Në pronësi
54-59	Fushë e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
69-83	Tokë, bujqësore (arë, pemëtoje, vresht, ullishte)	Në përdorim
84	Tokë bujqësore PF	Në pronësi
678-684	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
709,710,60-68	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
711-718	Furnizimi me ujë të pijshëm	Në pronësi

VENDIM**Nr.11, datë 7.1.2009****PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 7 janar 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 2 (dy) automjete.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 14 janar 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 6 (gjashtë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 7 janar 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 14 janar 2009, është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

4. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

5. Autokolonat ushtarake italiane gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së

Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.12, datë 7.1.2009

**PËR KUSHTET DHE PROCEDURËN E TJETËRSIMIT TË SIPËRFAQEVE TË TOKËS ME CILËSI
TË VEÇANTA, PËR LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 23 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim AKKP-ja) ngarkohet të kryejë procedurën paraprake për tjetërsimin, në pronësi të pronarëve të ndërtimeve (në vijim kërkuesit), kundrejt kërkesës dhe për llogari të fondit të kompensimit financiar, të sipërfaqeve të tokës, që plotësojnë cilësitë e veçanta, të përcaktuara si më poshtë vijon:

a) Sipërfaqet të jenë rrugëkalime parcelash bujqësore, sipërfaqe të zëna nga impiante bonifikuese, kanale kullimi apo vaditjeje, të cilat kanë këto cilësi:

i) Janë në pronësi të shtetit dhe të patransferuara në inventar të organeve të qeverisjes vendore, në bazë të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar;

ii) Janë të përfshira brenda një pasurie të paluajtshme, në pronësi të kërkuesit apo që rrethohet ose lidh dy a më shumë pasuri të paluajtshme, në pronësi të kërkuesit;

iii) Brenda tyre ose në lidhje funksionale me to, kërkuesi të ketë ngritur ndërtesa banimi, sociale apo industriale apo të jenë pjesë e një studimi urbanistik të miratuar, të patrajtuar nga legjislacioni përkatës, për legalizimin dhe urbanizimin e ndërtimeve pa leje;

iv. Janë në masë deri në 20 për qind të sipërfaqes së tokës, në pronësi të kërkuesit.

b) Kërkuesit të kenë paguar në numrin e llogarisë së caktuar nga AKKP-ja, për llogari të fondit të kompensimit të pronave, të krijuar sipas pikës 1, nenit 23 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, kapar, në masën 20% të kundërvlehtës në lekë, të sipërfaqeve, që do të tjetërsohen në pronësi të tyre, sipas çmimit përkatës, të përcaktuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave, sipas metodikës për vlerësimin e pronës së paluajtshme, miratuar me vendimin nr.183, datë 28.4.2005 të Kuvendit.

c) Kapari të jetë paguar për llogari të fondit të kompensimit të pronave jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së njoftimit prej AKKP-së, por përpara dërgimit të materialeve nga AKKP-ja te Ministri i Drejtësisë.

ç) Kërkesa të depozitohet në zyrën e AKKP-së në qendër, e shoqëruar me dokumentacion provues, sipas këtij vendimi.

d) Për sipërfaqet e zëna nga impiante bonifikuese, kanale kullimi apo vaditjeje të jetë marrë, paraprakisht, miratimi nga ministria përkatëse. Në rastet e ndryshimit të projekteve aplikuesi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duhet të paraqesë dhe të ndërtojë, me shpenzimet e veta, ndryshimet e mundshme në veprat në fjalë, për ruajtjen e funksionit.

2. Kërkesa për tjetërsimin, për llogari të fondit të kompensimit, të sipërfaqeve të përcaktuara në këtë vendim, paraqitet nga kërkuesit pranë zyrës së AKKP-së, në qendër me postë rekomande. Krahas kërkesës, sipas formularit tip, të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, kërkuesit duhet të paraqesin edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentin e lëshuar nga ZRPP-ja, që vërteton pronësinë e kërkuesit mbi pasuritë e paluajtshme,

të cilat ndodhen brenda apo rrethojnë ose lidhen nga sipërfaqja, që kërkohet të tjetërsohet, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe, sipas rastit, lejen e ndërtimit, dhënë nga organi përgjegjës në periudhën, kur është bërë ndërtimi apo studimin urbanistik, të miratuar.

b) Dokumentin e lëshuar nga ZRPP-ja, që vërteton pronësinë e shtetit mbi pasuritë e paluajtshme, që kërkohen të tjetërsohen, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe regjistrimin përkatës kadastral të kësaj sipërfaqeje pranë zyrave të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës, në këshillin e qarkut.

c) Planvendosjen e sipërfaqjes së kërkuar për t'u tjetërsuar, të lëshuar nga ZRPP-ja.

3. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit nga AKKP-ja kryhet sipas kësaj procedure:

a) Zyra e AKKP-së në qendër dërgon, për verifikim, në zyrën e AKKP-së në qark, në juridiksionin e së cilës ndodhet sipërfaqja, që kërkohet të tjetërsohet, brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së kërkesës, praktikën e plotë me të gjithë dokumentacionin, që shoqëron kërkesën. Dokumentacioni, nga zyra e AKKP-së në qendër, në zyrën e AKKP-së në qark, përcillet me inventar, ku listohen dokumentet e kërkesës.

b) Zyra e AKKP-së në qark, brenda 30 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të dokumentacionit, kryen verifikimin e hollësishëm dhe konfirmon faktin, nëse kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruar përmbushin kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi. Verifikimi i kushteve bëhet nëpërmjet inspektimit në terren nga punonjësit e zyrës së AKKP-së në qark. Gjithashtu, zyra e AKKP-së në qark i drejtohet organeve, që kanë lëshuar dokumentet me kërkesën për konfirmimin e vërtetësisë së tyre. Korrespondenca bëhet pjesë e dosjes. Zyra e AKKP-së në qark ka detyrë të kryejë saktësimin e kufijve të sipërfaqes, që kërkohet të tjetërsohet, duke kryer matje në terren, kur rezulton se dokumentacioni teknik ligjor, i paraqitur nga kërkuesi nuk përmban kufij ose dokumentacioni teknik nuk është i plotë. Shpenzimet e verifikimit dhe të matjes në terren parapaguhën nga kërkuesi sipas tarifës së miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Në përfundim të shqyrtimit sipas afateve të mësipërme, zyra e AKKP-së në qark ka detyrimin ta përcjellë dosjen, së bashku me relacionin teknik, të shoqëruar me inventarin e dokumenteve.

c) Relacioni teknik përmban përshkrimin e hollësishëm për verifikimin e kryer dhe përgjigjen e specifikuar për secilin nga kushtet përkatëse, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi. Relacioni përmban, gjithashtu, të dhënat e sakta për sipërfaqen, që kërkohet të tjetërsohet, me planvendosjen e saj për sipërfaqen në metra katrorë dhe çmimin e përlllogaritur në përputhje me shkronjën "b" të pikës 1 të këtij vendimi. Relacioni teknik mbyllet me përfundimet e paraqitura për përmbushjen ose jo të kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, nëpërmjet motivimit të veçantë të secilit prej tyre.

ç) Zyra e AKKP-së në qendër, brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së dosjes, pasi verifikon zbatimin e përpiktë të kërkesave të këtij vendimi, nga ana e zyrës së AKKP-së në qark, njofton kërkuesin, sipas rastit, për:

i) detyrimin për të paguar, për llogari të AKKP-së për fondin e kompensimit financiar, kaparin e përlllogaritur sipas këtij vendimi, të sipërfaqes që do tjetërsohet. Në njoftim duhet të përfshihet përshkrimi i hollësishëm i sipërfaqes së bashku me planimetrinë;

ii) mospërmbushjen e kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të përshkruara në mënyrë të hollësishme. Me anë të këtij njoftimi, kërkuesit i bëhet e ditur e drejta për të tërhequr kërkesën për tjetërsim. Nëse kërkuesi paraqet mandatpagesën e kaparit dhe nuk tërheq kërkesën, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, atëherë AKKP-ja, brenda dhjetë ditëve nga mbarimi i këtij afati, ia përcjell materialet Ministrit të Drejtësisë.

d) Kur vendimi i AKKP-së qender është në kundërshtim të plotë ose të pjesshëm me rekomandimin e AKKP-së qark, vendimi duhet të përmbajë, në mënyrë të arsyetuar, shkaqet, rrethanat ligjore dhe dokumentacionin provues, për vendimmarrje të ndryshme.

4. Kalimi i pronësisë së sipërfaqes, që do tjetërsohet për llogari të fondit të kompensimit financiar, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në bazë të materialeve të paraqitura nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së mandatpagesës origjinale, që vërteton pagesën e kaparit. Kalimi i pronësisë bëhet përmes kontratës standard të shitblerjes sipas dispozitave të Kodit Civil. Për lidhjen e kontratës, Këshilli i Ministrave autorizon një përfaqësues.

5. Ngarkohen ministri i Drejtësisë, drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe kryeregjistruesi i pasurive të paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

UDHËZIM
Nr.26/2, datë 7.1.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.26, DATË 4.9.2008 “PËR TAKSAT KOMBËTARE”,
TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, pika 3 “Përjashtimi nga taksat kombëtare” germa “b” ndryshon si më poshtë:

“b) personat fizikë ose juridikë, të cilët deklarojnë brenda muajit janar të vitit në vazhdim, se nuk do të qarkullojnë automjetet në pronësi të tyre gjatë vitit kalendarik, dhe dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit të automjetit.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.1, datë 8.1.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PËRDORIMIN E APARATEVE
TELEVIZIVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar,

UDHËZOJNË:

1. Tarifa e përdorimit të aparaturave radiotelevizive është 600 (gjashtëqind) lekë në vit.
2. Kjo tarifë llogaritet dhe paguhet nga përdoruesit familjarë vetëm për një marrës televiziv, pavarësisht nga numri i aparateve që kanë në familje. Për përdoruesit e tjerë jofamiljarë kjo tarifë paguhet për çdo aparat televiziv.
3. Me vjeljen e kësaj tarife ngarkohen zyra e pagesës së energjisë elektrike. Vjelja e kësaj tarife duhet të bëhet brenda tremujorit të parë të çdo viti.
4. Faturat tatimore të energjisë elektrike të OSSH-së, në tremujorin e parë të vitit fiskal do të kenë në fund, si një zë më vete, tarifën e shërbimit për përdorimin e aparateve televizive sipas udhëzimit të Ministrit të Financave nr.17/4, datë 26.12.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.
5. Mbi tarifat e shërbimit të përfshira në këtë udhëzim nuk aplikohet TVSH-ja.
6. Pagesat e tarifës vërtetohen për përdoruesit në librezën e pagesës së energjisë elektrike ku shënohet “tarifa e paguar në vitin _____, data e pagesës, si dhe firma dhe vula e punonjësit të ngarkuar me vjeljen e kësaj

tarife.

7. Për shërbimin e kryer, OSSH-ja, përfiton 5% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe ka transferuar në llogarinë përkatëse të thesarit.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
I RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR
Petrit Beci

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 14.1.2009
Doli nga shtypi më 15.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 12 lekë